



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Rr. Ukshin Kovaqica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://ëëë.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Plani i punës i Fakultetit Juridik për vitin 2022

Plani i punës i Fakultetit Juridik për vitin 2022, përmban objektivat dhe aktivitetet kryesore të cilat planifikohen të realizohen gjatë kësaj periudhe kohore. Ky planë në vete përmban çështjet kyçe për realizimin e të cilave kërkon një koordinim të plot në mes menaxhmentit, stafit akademik dhe studentëve.

Objektivat:

I. Realizimi i procesit mësimor sipas planit të parashikuar

Fakulteti Juridik sikurëse edhe viteve të tjera, synon të realizojë procesin mësimor sipas planit të përcaktuar për vitin 2022. Për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor, do të vihen në pah të arriturat dhe sfidat që ka pasur në vitin paraprak dhe sfidat që mund ti hasë në këtë vit. Për realizimin sa më efikas të procesit mësimor, do të merren masat e duhura nga menaxhmenti i Fakultetit Juridik, që i tërë procesi mësimor të realizohet pa ndonjë pengesë si: mbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve, mbajtja e kolloqfjumeve dhe provimeve, realizimin e planprogramit mësimor të përcaktuar në syllabuse për secilën lëndë, regjistrimin e studentëve të rinjë, si dhe zhvillimi i aktiviteteve jasht kurrikulare për studentët, etj.

Orët e ligjëratave dhe ushtrimeve të humbura për shkak të festave zyrtare apo shtyerjes së tyre për arsye të ndryshme, në koordinim të plotë në mes menaxhmentit, stafit akademik dhe studentëve, do të kompensohen brenda afateve të përcaktuara. Duke pasur në konsideratë gjendjen me pandemin COVID -19, Fakulteti Juridik sikurse edhe në të kaluarën, do të bëjë përpjekje maksimale që të realizojë procesin mësimorë sipas objektivave të përcaktuara.

Ndërsa, sa i përket mbajtjes së provimeve, Fakulteti Juridik do të anagzohet që i tërë procesi të zhillohet konform akteve dhe normave të UIBM, duke respektuar kohën e mbajtjes së tyre, efikasitetin, transparencën dhe arritjen e objektivave të synuara. Forma e mbajtjes së provimeve do të mbahen në format e përcaktuara me Statutin dhe Aktet e tjera të UIBM duke respektuar autonomiën e plotë të stafit akademik. Për të gjitha afatet e provimeve do të merren masat e duhura që i tërë procesi të zhvillohet në atë mënyrë ku do të respektohet koha e shpalljes së afatit për provime, paraqitja e tyre nga ana e studentëve, mbajtja e tyre dhe finalizimi i rezultateve. I tërë procesi do të zhvillohet në koordinim të plotë në mes menaxhmentit, stafit akademik dhe studentëve.

II. Kompletimi, dërgimi dhe mbrojtja e RVV-së, për programin Mastër të FJ, dhe implementimi i rekomandimeve të ekspertëve të akreditimit për Programin LLB të FJ

Sa i përket implementimit të rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë për programin Juridik LLB, Fakulteti Juridik ka finalizuar planin e implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportin final të Ekspertëve Ndërkombëtarë në procesin e ri-akreditimit për Fakultetin Juridik. Implementimi i rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve Ndërkombëtarë do të vazhdojë të realizohet edhe gjatë vitit 2022.

Fakulteti Juridik synon që gjatë këtij viti të aplikojë për Akreditim në Programin Mastër, ku për një program të tillë kemi synuar të aplikojmë vitin që e lamë pas, mirëpo për shkak të ndryshimeve të ndodhura më vendimet e marrura nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim (AKA), një gjë e tillë na u pamundësua si njësi akademike. Fakulteti Juridik do të bëjë përpjekje t'i përmbush standardet sipas vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA), të përgaditë Programin për nivelin Mastër dhe të bëjë mbrojtjen e tij me suksesë.

III. Realizimi i aktiviteteve jashtë-kurrikulare

Me qenë se është konstituar dhe funksionalizuar Instituti për Studime dhe Hulumtime Juridike dhe Ligjore, gjatë vitit 2022 synohet të botohet revista shkencore e Fakultetit “Ius Publicum Ius Privatum”.

Po ashtu, gjatë vitit 2022 Fakulteti Juridik synon të zhvillojë aktivitete jashtë-kurrikulare të cilat kanë për qëllim zhvillimin e shkathtësive të caktuara të cilat nuk mund të ofrohen nga programi zyrtar i fakultetit. Në këtë drejtim do të organizohen: trajnime, vizita studimore, konferenca, etj.

Klinikat Juridike të Fakultetit Juridik që kanë filluar funksionimin e tyre në vitin 2017, parashikohet të zgjerohen me realizimin edhe të klinikës civile, administrative dhe kushtetuese.

IV. Organizimi i ligjëratave dhe debateve me mysafir të ndryshëm nga bota akademike dhe jo vetëm

Gjatë viti 2022 Fakulteti Juridik synon të organizojë ligjërata me mysafir të profileve të ndryshme me qëllim avancimin në aspektin profesional për studentë dhe në të njëjtën kohë kontribuojnë në ngritjen e programit Juridik. Të ftuar do të jenë: profesor, gjyqtar, prokuror, avokat, noter, mediator, etj.

Vitet paraprake na kanë deshmuar se ligjëratat dhe diskutimet e studentëve me mysafir të ndryshëm mund të shndërrohen në një forum të vërtetë të debatit akademik, prandaj fakulteti edhe në vitin 2022 do të vazhdoj me shumë përkushtim këtë praktikë.

V. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare

Edhe pse Fakulteti Juridik tashmë ka një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve për bashkëpunim me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, sidomos në fushën e drejtësisë, edhe gjatë vitit 2022 synojmë të arrijm marrëveshje edhe me institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si: universitete, institute dhe institucione të tjera të zbatimit të

ligjit, e të cilat vlerësohen se ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejt apo indirekte në avancimin profesional të stafit akademik dhe studentëve. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja edhe gjatë vitit 2022 ka për qëllim që profesorëve dhe studentëve të ju mundësojë ngritjen akademike dhe profesionale, si dhe të nxis mobilitetin.

VI. Organizimi i debateve dhe konferencave shkencore

Në dhjetor të vitit 2021 është mbajtur Konferenca Shkencore e organizuar nga Fakulteti Juridik, e cila ishte mjaftë e suksesëshme si për nga përmbajtja po ashtu edhe pjesmarrja e studiuesëve. Edhe gjatë vitit 2022, Fakulteti Juridik synon dhe planifikon konferenca të tilla shkencore. Po ashtu, gjatë këtij viti përveç konferencave shkencore, synojmë të organizojmë tryeza të rrumbullakta dhe debate të ndryshme kryesisht në fushën juridike, synimi i të cilave do të jetë diskutimi i problemeve kyçe në fushën e drejtësisë, si dhe çështjeve akademike nga fusha e studimeve juridike. Synimi themelor i këtyre organizimeve do të jetë ofrimi i qasjeve, trajtimeve dhe rekomandimeve shkencore për zgjidhjen e problemeve të caktuara dhe aktuale nga fusha e drejtësisë.

Prof. Asoc. Dr. Agron BEKA

Dekan

Ky raport i dorëzohet:

- 1. Rektorit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;*
- 2. Prorektorit për mësim të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”;*
- 3. Arkivit të Fakultetit.*